

VENDIM
Nr. 43, datë 8.11.2024

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME
Vlorë SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); VKM-në nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958); si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 8.11.2024, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a.’”,

KONSTATON SE:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a., me shkresën nr. 2817 prot., datë 3.9.2024; me shkresën nr. 2901 prot., datë 11.9.2024, plotësimet, me lëndë “Kërkesë për pajisje me licencë”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim për herë të parë.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për herë të parë të Shoqërisë Rajonale UK Vlorë sh.a. në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” (VKM nr. 302).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a. (NUIS: M37202202E) është themeluar më datë 20.9.2023, me aksionarë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me 51%, bashkitë: Vlorë me 41.35%, Himarë me 4.6%, Selenicë me 3.05%.

b) Shoqëria Rajonale UK Vlorë sh.a. deklaron se ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 309,732 banorë të bashkive Vlorë, Himarë, Selenicë;

c) Drejtues teknik i shoqërisë z. Kendi Manaj është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, me Master profesional në Hidroteknikë, në vitin 2018 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e shoqërisë Rajonale UK Vlorë sh.a, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe të kanalizimeve të

mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e shoqërisë Rajonale UK Vlorë sh.a. është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a. me (NUIS M37202202E), në kategoritë:

- a) Kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
- b) Kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura;

2. Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

- a) Drejtues ligjor – Sokol Kananaj;
- b) Drejtues teknik – Kendi Manaj.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a. janë bashkitë Vlorë, Himarë, Selenicë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a. detyrohet të nënshkruajë Kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

7. Vendimi i KKRR-së nr. 245, datë 2.6.2022, “Për licencimin e Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Vlorë sh.a.” dhe vendimi i KKRR-së nr. 271, datë 9.7.2021, “Për licencimin e Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Selenicë sh.a.”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARE
Evis Shurdha